



KONGRESISTI WILSON I KËRKON SERBISË T'I NDALË KËRCËNIMET NDAJ KOSOVËS DHE TË SHKËPUTET NGA RUSIA, KINA E IRANI



Kongresisti amerikan Joe Wilson thotë se Serbia duhet t'i japë fund varësisë nga energjia ruse, të distancohet nga Moskua, Pekini dhe

Teherani, si dhe të veprojë plotësisht në linjë me institucionet perëndimore. Në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të Radios

Evropa e Lirë, Wilson rikonfirmoi mbështetjen e tij për pavarësinë e Kosovës dhe e kritikoi Serbinë për, siç tha, kërcënime të vazhdueshme

SONDAZHI NGA NDI: RRRITET PESIMIZMI DHE DËSHIRA PËR T'U LARGUAR NGA KOSOVA, ÇMIMET DHE ENERGJIA, SHQETËSIMET KRYESORE



KURTI: MBI 12 MIJË VIKTIMA TË DOKUMENTUARA TË LUFTËS, SERBISË T'I BËHET TRYSNI T'I HAPË ARKIVAT



OPINION

"LULE GJELI" DHE NEPËRKA MIHALI!

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



LUSHTAKU VIZITON VENDIN KU DYSHOHET PËR VARREZË MASIVE: KËRKOJMË PËRGJEGJËSI PËR AUTORËT E KËTIJ KRIMI

SHQIPËRIA, NDËR VENDET ME AJRIN MË VDEKJEPRURËS NË EVROPË

EKONOMI



TREGU I BE-së MBETET I MBYLLUR PËR QUMËSHIN E KOSOVËS

INFLACIONI GODET PELETIN, ISH-KREU I OEk-ut: ÇMIMI U RRIET 59 % BRENDË NJË VITI

SPORT



DRITA SIGURON KUALIFIKIMIN DRAMATIK NË RAUNDIN E TRETË TË UEFA CONFERENCE LEAGUE

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SONDAZHI NGA NDI: RREDIT PESIMIZMI DHE DËSHIRA PËR T'U LARGUAR NGA KOSOVA, ÇMIMET DHE ENERGJIA, SHQETËSIMET KRYESORE



Ibrahim Berisha (RFE/RL)

PRISHTINË, 29 KORRIK - NDI - zyra në Kosovë - ka bërë një sondazh të ri, i realizuar me 1 200 qytetarë të rritur në gjithë Kosovën, ndërmjet 15 prillit dhe 5 majit 2026, i publikuar sot. Rezultatet janë përcaktuar në bazë të gjinisë, rajonit dhe moshës, në përputhje me të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024.

Sipas të gjeturave kryesore, qytetarët e Kosovës janë bërë më pesimistë për drejtimin e vendit, ndërsa është rritur ndjeshëm përqindja e atyre që do të largoheshin përgjithmonë po ta kishin mundësinë. Kostoja e jetesës, çmimet e energjisë dhe papunësia paraqiten shqetësimet kryesore, ndërsa sigurimi shëndetësor renditet në krye të prioritetëve konkretë të qytetarëve.

Rritet numri i qytetarëve që mendojnë se Kosova po shkon në drejtim të gabuar

Sipas rezultateve, 38 për qind e të anketuarve mendojnë se gjërat në Kosovë po shkojnë në drejtim të gabuar. Vetëm 31 për qind vlerësojnë se vendi është në drejtimin e duhur, ndërsa 27 për qind nuk e shohin situatën as pozitivisht dhe as negativisht. Krahasuar me dhjetorin e vitit 2024, kur vetëm 24 për qind mendonin se Kosova po shkonte në drejtim të gabuar, kjo kategori është rritur për 14 pikë

përqindjeje. Në të njëjtën periudhë, vlerësimi se vendi po ecën në drejtimin e duhur ka rënë nga 38 në 31 për qind.

Rritet përsëri dëshira për emigrim, të rinjtë më të gatshëm për t'u larguar

Rreth 62 për qind e qytetarëve thonë se do të qëndronin në Kosovë, ndërsa 28 për qind do të zgjidhnin të shpërnguleshin përgjithmonë në një shtet tjetër. Tetë për qind nuk janë të sigurt. Dëshira për t'u larguar është rritur ndjeshëm krahasuar me dhjetorin e vitit 2024, kur këtë mundësi e zgjidhnin 16 për qind e qytetarëve. Në anën tjetër, përqindja e atyre që do të qëndronin ka rënë nga 67 në 62 për qind. Tendenca është më e theksuar te të rinjtë. Rreth 44 për qind e grupmoshës 18-24 vjeç deklarojnë se do të largoheshin nga Kosova, krahasuar me 37.1 për qind të grupmoshës 25-34 vjeç dhe 31.5 për qind të atyre nga 35 deri në 44 vjeç, raporton Telegrafi.

Çmimet, energjia dhe papunësia, tri problemet kryesore

Çmimet e mallrave konsiderohen si problemi më i madh për Kosovën gjatë vitit të ardhshëm, të përmendura nga 56.6 për qind e të anketuarve.

Në vendin e dytë janë çmimet dhe furnizimi me energji elektrike me 43.8 për qind, ndërsa papunësia renditet e treta me 40.2 për qind.

Korrupsioni është përmendur nga 18.1 për qind, siguria publike nga 14.7 për qind, dialogu me Serbinë nga 11.2 për qind dhe tensionet ndëretnike nga 7.8 për qind. Rezultatet tregojnë se shqetësimet ekonomike dhe sociale kanë peshë dukshëm më të madhe sesa temat politike dhe të sigurisë.

Faturat dhe ushqimi rëndojnë më së shumti buxhetin familjar

Kur janë pyetur se cilat shpenzime janë më të vështira për t'u përballuar nga familjet e tyre, 62.3 për qind kanë përmendur faturat e shërbimeve publike. Blerja e produkteve ushqimore është problem për 46.9 për qind të familjeve, ndërsa shpenzimet për kujdesin shëndetësor janë përmendur nga 29.8 për qind. Pagesat e kredive dhe borxheve paraqesin vështirësi për 20.8 për qind të të anketuarve.

Sigurimi shëndetësor, prioriteti kryesor i qytetarëve

Sigurimi shëndetësor është çështja më e rëndësishme konkrete për 58.3 për qind të

qytetarëve. Ai pasohet nga shërbimet cilësore në kujdesin parësor shëndetësor me 35.8 për qind dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat me 35 për qind. Përmirësimi i cilësisë në arsim është prioritet për 25.5 për qind, luftimi i dhunës ndaj grave për 14.2 për qind, pensionet për 12 për qind dhe mungesa e çerdheve për 10.8 për qind.

Shumica mbështesin demokracinë, por 15 për qind do ta pranin autoritarizmin

Pavarësisht pakënaqësive ekonomike dhe politike, 75.3 për qind e qytetarëve deklarojnë se demokracia është gjithmonë më e preferueshme se çdo formë tjetër e qeverisjes. Megjithatë, 15 për qind mendojnë se në rrethana të caktuara një qeveri autoritare mund të jetë më e preferueshme, ndërsa 5.5 për qind thonë se për njerëzit si ata nuk ka rëndësi nëse regjimi është demokratik apo jodemokratik. Korrupsioni konsiderohet kërcënim më i madh për demokracinë nga 41.1 për qind e qytetarëve. Pas tij renditen pabarazia ekonomike me 37 për qind dhe mungesa e llogaridhënies së politikanëve me 33.3 për qind. Dobësimi i sundimit të ligjit dhe mungesa e besimit në institucione janë përmendur nga 26.3 për qind, ndërsa

përhapja e informatave të rreme ose mashtruese nga 20.3 për qind.

FSK-ja, Policia dhe KFOR-i, institucionet më të besueshme

Duke bashkuar vlerësimet "mirë" dhe "shkëlqyeshëm", Forca e Sigurisë së Kosovës gëzon nivelin më të lartë të besimit, me rreth 95 për qind. Policia e Kosovës arrin afërsisht 93 për qind, ndërsa KFOR-i rreth 91 për qind.

Institucionet fetare vlerësohen pozitivisht nga rreth 87 për qind, Gjykata Kushtetuese nga 76 për qind dhe pushteti lokal nga rreth 73 për qind.

Në fund të renditjes gjenden partitë politike, me vetëm rreth 40 për qind vlerësime "mirë" ose "shkëlqyeshëm". Qeveria dhe ekzekutivi arrijnë rreth 53 për qind, ndërsa Kuvendi i Kosovës rreth 52 për qind.

ShBA-ja dhe NATO-ja vazhdojnë të vlerësohen më së larti

Në një shkallë nga një deri në pesë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë marrë vlerësimin mesatar 4.70, duke u renditur të parat. NATO-ja pason me 4.68, Gjermania me 4.51 dhe Mbretëria e Bashkuar me 4.41. Bashkimi Evropian dhe Turqia kanë marrë vlerësim të njëjtë prej 4.29. Në fund të listës janë Kina me 1.35 dhe Rusia me 1.14. Rreth 86 për qind pajtohen se SHBA-ja është mbështetësi më i madh i Kosovës, ndërsa 75 për qind e thonë të njëjtën për Bashkimin Evropian. Gjithashtu, 66 për qind besojnë se Kosova nuk mund t'ia dalë pa mbështetjen amerikane, ndërsa 68 për qind vlerësojnë se vendi nuk mund t'ia dalë pa mbështetjen e BE-së.

Më shumë gra në udhëheqjen e partive shihet si faktor pozitiv

Për 64.9 për qind të qytetarëve, prania e më shumë grave mes kandidatëve kryesorë të një partie politike përbën faktor pozitiv në vendimin e tyre për votim.

Ky qëndrim është më i përhapur te gratë, me 73.3 për qind, por mbështetjet edhe nga shumica e burrave, me 56.6 për qind. Vetëm 3.4 për qind në nivel të përgjithshëm e konsiderojnë përfaqësimin më të madh të grave si faktor negativ.

KURTI: MBI 12 MIJË VIKTIMA TË DOKUMENTUARA TË LUFTËS, SERBISË T'I BËHET TRYSNI T'I HAPË ARKIVAT

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) ka dokumentuar 12 230 viktima të luftës në Kosovë në periudhën 1 janar 1998 - 20 qershor 1999. Ai i bëri thirrje faktorit ndërkombëtar që t'i bëjë trysni Serbisë që t'i hapë arkivat e ushtrisë.

Gjatë lansimit të raportit të IKKL-së, Kurti tha se kjo listë është preliminare dhe do të përditësohet vazhdimisht, duke u kërkuar qytetarëve dhe organizatave që mund të kenë dëshmi për krime, të bashkëpunojnë me institutin. "Sepse pa dokumentim nuk ka kujtesë, pa kujtesë nuk ka drejtësi dhe pa drejtësi nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme", tha Kurti.



Kurti tha se ky raport po publikohet një ditë pasi institucionet nisën gërmimet në Kalludër të Zubin Potokut, pas dyshimeve se aty ekziston një varrezë masive. Sipas tij, kjo është dëshmi se plagët e luftës mbeten të hapura dhe për shumë familje, që ende nuk kanë gjetur më të dashurit e

tyre, lufta nuk ka përfunduar. Lidhur me gërmimet në Zubin Potok, autoritetet kanë arrestuar dy persona. Sipas kryeministrit në detyrë, për familjet çdo gërmim është shpresë, çdo identifikim është një hap drejt së vërtetës e drejt drejtësisë. "Përderisa këto gërmime janë rezultat i punës

së institucioneve tona, moszbatimi nga Serbia i Deklaratës së Brukselit për të zhdukurit me dhunë, e dakorduar më 2 maj 2023, përkatësisht refuzimi për të hapur arkivat e ushtrisë është dëshmi se shteti fqinj vazhdon t'i ikë drejtësisë për krimet e kryera në vendin tonë gjatë luftës së fundit. Andaj e përsërisim thirrjen ndaj faktorëve ndërkombëtarë të shtojnë trysninë ndaj Serbisë, që mes tjerash, të ndryshohet vendimi për klasifikim 30-vjeçar deri më 2044 dhe të hapet arkiva e Brigadës së Motorizuar 37 të ushtrisë jugosllave në mënyrë që të kemi informacione për zbardhjen e fatit të të zhdukurve me dhunë", shtoi ai. Deklarata e 2 majit parasheh zotime nga Kosova dhe Serbia

për zbardhjen e fatit të afër 1 600 personave të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998/99. Në të nuk përmendet konkretisht hapja e arkivave ushtarake apo policore, po aty përmendet fjala "dokumente konfidenciale". Kurti tha, po ashtu, se IKKL-ja ka dokumentar se gjatë luftës janë vrarë 1 047 fëmijë të moshës 0 deri në 17 vjeç, dhe 94 prej tyre kanë vdekur si pasojë e kushteve të luftës. "Ndërsa ende nuk dihet për fatin e 100 fëmijëve të zhdukur me dhunë", tha Kurti. Ata janë pjesë e mbi 1 500 personave, shumica shqiptarë, që vazhdojnë të jenë të zhdukur. Sipas raportit, 81.3 për qind e të gjitha viktimave të dokumentuara janë regjistruar në muajt mars dhe qershor të vitit 1999. Në këtë periudhë përkatësisht u vranë 9 948 njerëz.

SENATI MBËSHTET PROJEKTLIGJIN PËR SANKSIONE NDAJ RUSISË

UASHINGTON, 29 KORRIK - Senati amerikan ka dhënë një nga mbështetjet më të fuqishme dypartiake për Ukrainën që kur presidenti Donald Trump u rikthye në Shtëpinë e Bardhë, pasi ligjvënësit votuan me 86 vota për dhe 12 kundër avancimit të një legjislacioni që synon ashpërsimin e presionit ekonomik ndaj Rusisë dhe Iranit.

Votimi procedural, i mbajtur vetëm pak orë pas funeralit të senatorit Lindsey Graham nga Karolina e Jugut, hartuesit kryesor të projektligjit, u zhvillua menjëherë pasi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u bëri thirrje senatorëve ta votonin projektligjin gjatë një takimi me dier të mbyllura, përpara se ta ndiqte votimin nga salla e Senatit.

Projektligji, i quajtur zyrtarisht Akti Lindsey O. Graham për Vendosjen e Sanksioneve ndaj Rusisë dhe Iranit i vitit 2026, i

jep presidentit Trump autoritetin të vendosë tarifa deri në 200 për qind ndaj blerësve më të mëdhenj në botë të naftës dhe gazit natyror rus, teksa zgjeron sanksionet që kanë për shënjestër institucionet financiare të Rusisë, elitën politike, oligarkët dhe "flotën në hije" që përdoret për t'iu shmangur kufizimeve ekzistuese. Ai, po ashtu, zgjat sanksionet ndaj Iranit deri në vitin 2031.

Edhe pse projektligji duhet të miratohet përfundimisht në Senat dhe më pas të shqyrtohet në Dhomën e Përfaqësuesve pas pushimit të gushtit, vihet në pah një konsensus i rrallë dypartiak, se presioni ekonomik mbetet një nga mjetet më të fuqishme të Uashingtonit kundër Moskës.

Pas takimit me senatorët Zelensky tha se projektligji ka një rëndësi që shkon përtej ndikimit të tij të drejtpërdrejtë ekonomik. "Ky projektligj është



shumë i rëndësishëm", tha ai. "Presioni, përmes sanksioneve, ndaj Rusisë është shumë i rëndësishëm. Nuk bëhet fjalë vetëm për paratë që Rusia përdor për ta financuar këtë

luftë. Ai është gjithashtu një sinjal i madh për Evropën, një sinjal i madh për Ukrainën dhe një mbështetje e madhe për popullin tonë". Ai tha se shpreson që

projektligji do të shndërrohet në ligj, duke theksuar se ishte mirënjohës për diskutimin dypartiak dhe optimist për një rezultat pozitiv.

Izraeli përgatitet për zgjedhje

JERUSALEM, 29 KORRIK - Izraeli voton më 27 tetor në zgjedhje. Debati do të dominohet nga përgjegjësitë për sulmin e 7 tetorit, luftërat në disa fronte, shërbimi ushtarak i hebrenjve ultra-ortodoksë dhe rritja e kostos së jetesës.

Përgjegjësia për dështimin në parandalimin e sulmit të Hamasit më 7 tetor 2023 është një nga çështjet kryesore të zgjedhjeve izraelite.

Opozita kërkon ngritjen e një komisioni të pavarur

shtetëror, ndërsa qeveria e Benjamin Netanyahu propozon një komision dypartiak, anëtarët e të cilit do të emërohen nga politika.

Kryeministri përballët gjithashtu me kritika për politikën e mëparshme ndaj Katarit, financues i rëndësishëm i Hamasit. Fushata pritet të përqendrohet edhe te strategjia e sigurisë.

Pas 7 tetorit Izraeli është përfshirë në operacione të zgjatura në Gazë, Liban, Siri,

Bregun Perëndimor, Iran dhe Jemen. Mobilizimi i përsëritur i rezervistëve ka sjellë mungesa personeli dhe kosto të larta ekonomike.

Një tjetër përplasje lidhet me përjashtimin nga shërbimi ushtarak të studentëve ultra-ortodoksë. Partitë fetare dhe Likud-i kërkojnë ruajtjen e përjashtimeve, ndërsa shumica e opozitës mbështet rekrutimin e tyre.

Pavarësisht prej rritjes ekonomike dhe papunësisë së



ulët, Izraeli ka një nga kostot më të larta të jetesës. Mungesa e banesave, konkurrenca e kufizuar dhe dyfishimi i

buxhetit të mbrojtjes që prej vitit 2023 po shtojnë presionin mbi familjet dhe financat publike.



KONGRESISTI WILSON I KËRKON SERBISË T'I NDALË KËRCËNIMET NDAJ KOSOVËS DHE TË SHKËPUTET NGA RUSIA, KINA E IRANI

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kongresisti amerikan Joe Wilson thotë se Serbia duhet t'i japë fund varësisë nga energjia ruse, të distancohet nga Moska, Pekini dhe Teherani, si dhe të veprojë plotësisht në linjë me institucionet perëndimore. Në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë, Wilson rikonfirmoi gjithashtu mbështetjen e tij për pavarësinë e Kosovës dhe e kritikoi Serbinë për, siç tha, kërcënime të vazhdueshme. Ai tha se Beogradi duhet përfundimisht t'i bashkohet Bashkimit Evropian dhe NATO-s, por argumentoi se kjo do të kërkonte një shkëputje të qartë nga pushtetet autoritare. Wilsoni ka sponsorizuar një rezolutë në Kongresin Amerikan që kërkon që Sesioni Vjetor i vitit 2027 i

Asamblesë Parlamentare të OSBE-së të mbahet në Çarlston të Karolinës së Jugut e jo në Beograd. Derisa tha se synimi kryesor është të mbahet ky takim në Shtetet e Bashkuara, ai përmendi marrëdhëniet e Serbisë me Rusinë, Kinën dhe Iranin, si dhe qasjen e saj ndaj Kosovës, si disa nga shqetësimet e tij lidhur me Beogradin si nikoqir i këtij takimi. Asambleja Parlamentare e OSBE-së thotë se delegacioni amerikan më herët e kishte njoftuar atë se Çarlstoni nuk mund të organizonte sesionin dhe se pas kësaj Beogradi u përzgjodh në bazë të procedurave të përcaktuara. Wilsoni tha se shqetësimet logjistike që lidhen me ushqimin, stafin dhe përkthimin janë zgjidhur ndërkohë, dhe sugjeroi se

Beogradi mund ta organizojë këtë takim në vitin 2028.

Kongresist Wilson, cili është, sipas jush, argumenti më i fortë që Beogradi nuk duhet të jetë nikoqir i takimit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së në vitin 2027?

Joe Wilson: Një shqetësim që do të kisha për mbajtjen e tij në Beograd, Serbi, është ajo që - për mua, termi që përdor është - ndikimi i tepruar i kriminelit të luftës [presidenti rus Vladimir] Putin në Serbi, gjë që e them me keqardhje. Nuk më gëzon kjo, por në të vërtetë Serbia ende blen naftë dhe gaz nga kriminelit i luftës Putin. Kompania shtetërore e naftës, për fat të keq, NIS, është blerë nga kriminelit i luftës Putin. Për më tepër, ekziston një ndikim i tepruar i Partisë Komuniste Kineze sa i përket komunikimeve dhe

investimeve të tjera. Dhe pastaj, për ta bërë edhe më të papranueshme, sipas meje, është lidhja me diktaturën në Teheran. Prandaj, vazhdimisht, Serbia prej vitesh ka treguar një afërsi me diktaturën e Khameinit. Serbia është veçanërisht një vend që duhet të jetë i madh dhe duhet të jetë pjesë e BE-së, duhet të jetë në të vërtetë pjesë e NATO-s. Sapo jam kthyer nga Sllovenia. Sa emocionuese është të shohësh ish-republikat jugosllave që po ecin kaq mirë. Jam shumë mirënjohës. E di suksesin e Kroacisë dhe me të vërtetë shpresoj për Malin e Zi dhe gjithashtu për Maqedoninë e Veriut. Dhe Kosovën - kam qenë në Prishtinë - dhe pavarësia e saj, për mua, është shumë e rëndësishme. Dhe, për fat të keq, kërcënimet nga Serbia

thjesht - në shekullin XXI - nuk duhet të ndodhin. Një mënyrë për ta bërë këtë është shkëputja e marrëdhënieve dhe ndikimit të kriminelit të luftës Putin në Serbi, shkëputja e ndikimit të Partisë Komuniste Kineze, i cili është kaq tinëzar, dhe ndalimi i çdo lidhjeje me diktaturën në Teheran, synimi i së cilës është vetëm vdekja e Amerikës.

A keni mbështetje të mjaftueshme në Kongres ose në administratën e Trumpit për ta ndryshuar vendimin për Beogradin dhe samitin e OSBE-së? Por, bazuar në përgjigjen tuaj të mëparshme, duhet t'ju pyes: A keni mbështetje të mjaftueshme për ndryshimin e qasjes amerikane ndaj Serbisë? Dhe duhet të përmend gjithashtu se, 10

LUSHTAKU VIZITON VENDIN KU DYSHOHET PËR VARREZË MASIVE: KËRKOJMË PËRGJEGJËSI PËR AUTORËT E KËTIJ KRIMI

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ka vizituar fshatin Kalludër në Zubin Potok, vendin ku dyshohet se gjenden mbetjet mortore të disa personave të vrarë gjatë luftës në Kosovë. Ai ka kërkuar zbardhjen e fatit të tyre dhe drejtësi për familjet e tyre. Lushtaku, përmes një postimi në "Facebook", ka kujtuar se 19 maji i vitit 1999 ishte dita e fundit kur këta persona u panë të gjallë, ndërsa familjet e tyre vazhdojnë të jetojnë me dhimbjen e pritjes. "Që nga ajo ditë, familjet e tyre dhe shoqëria jonë jetojnë me dhembjen e pritjes, ndërsa Kosova mban ende një nga plagët e mëdha të luftës", ka shkruar Lushtaku. Ai ka përmendur emrat e Idriz

Rrecit, doktorit Fatmir Fazlija, profesorit Demir Ahmeti, Shaqir, Samir, Xhemal, Salih, Naser, Zymer, Tahir, Selim, Bekim dhe Xhevdet Mëziut, Sahit Beranit, Ali Halitit, Adem Ademit, Adem Beqirit, Hasan Dërvarit, Shaip, Mahir, Faton, Shkëlzen dhe Nazim Ujkanit. Sipas tij, ky grup përfaqësonte "zërin e dijes dhe të atdhedashurisë", ndërsa ka kërkuar zbardhjen e plotë të së vërtetës dhe përgjegjësi për autorët e këtij krimi. "Me shpresën që ky vend do t'u japë fund viteve të gjata të pritjes dhe se më në fund ata do të kthehen pranë familjeve të tyre, për t'u prehur me dinjitet në tokën e vendlindjes për të cilën dhanë aq shumë", ka shkruar kryetari i Skenderajt.



ditë më parë, Uashingtoni dhe Beogradi nisën një dialog strategjik.

Joe Wilson: Pikëpamja ime është se ajo që po bëj, para së gjithash, është në favor të mbajtjes së Asamblesë Parlamentare të vitit 2027 në Amerikë. Ky është 98 për qind interesi im. Por, në të njëjtën kohë, jam i shqetësuar për ndikimin e tepruar të kriminelit të luftës Putin në Serbi. Beogradi duhet të jetë pjesë e qytetërimit modern perëndimor, siç e shohim, siç e pashë unë në Lubjanë.

A po bëni thirrje jo vetëm për zhvendosjen e takimit të OSBE-së nga Beogradi, por edhe që ShBA-ja ta rishqyrtojë marrëdhënien e saj më të gjerë politike, ushtarake ose ekonomike me Serbinë?

Joe Wilson: Serbia, ne e dimë se çfarë vendi historik është dhe sa pozitiv mund të jetë dhe duhet të jetë. Edhe gjatë Luftës së Ftohtë, atje ekzistonte një nivel pavarësie nga Moska. Kjo pavarësi duhet të forcohet, jo të lejohet të vazhdojë kjo gjendje, në mënyrë që, sido që të jetë e mundur, të arrihet. Duhet të ketë afim të plotë me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n. Është koha për t'i ndërprerë marrëdhëniet me diktaturat e Pekinit, Moskës dhe Teheranit. Bota po ndryshon. Ne e shohim këtë. Diktatorët janë në arrati. Assadi është zhvendosur nga Siria në Moskë. Maduro është në burg në Nju Jork. Khameini ka vdekur. Ai është me 40 mijë njerëzit që vrau më herët këtë vit. Tani është koha që Serbia

të jetë pjesë e qytetërimit perëndimor, sepse qytetërimi perëndimor do të triumfojë.

Por, Beogradi ka ndërmarrë disa hapa – Serbia është në proces negociatash me Rusinë për ndalimin e importit të naftës ruse dhe, gjithashtu, Beogradi është në komunikim me Uashingtonin për këtë çështje. A mendoni se kjo është shenjë e mirë? A është e mjaftueshme?

Joe Wilson: Jo, jo, jo. Negociatat nuk mjaftojnë. Ata mund të veprojnë në mënyrë të njëanshme. Nuk kanë nevojë të marrin leje nga Donald Trump. Në të vërtetë, Hungaria po ndërmerr çdo hap për të ndaluar blerjen e naftës dhe gazit. Falë Zotit. E dimë se Bullgaria në fakt po heq ndikimin e kompanive ruse të naftës atje – Lukoil. Dhe kështu, vazhdimisht, vendet po tregojnë mospajtimin e tyre ndaj vrasjeve masive që po kryhen nga kriminelit të luftës Putin. Dhe mënyra për ta ndaluar këtë është të mos financohet kriminelit të luftës Putin. Dhe kjo nuk vlen vetëm për Serbinë, por edhe për Indinë. Jam shumë mirënjohës që presidenti Trump po punon me Indinë për të ndryshuar blerjet e saj nga Rusia. Kjo është një përpjekje globale dhe Serbia nuk duhet të negociojë. Serbia thjesht duhet ta bëjë këtë, sepse është gjëja e duhur për të promovuar lirinë dhe demokracinë në botë.

A besoni se rezoluta e propozuar nga 41 kolegë tuaj mund të jetë arsye për ndryshimin e vendimit, ose

për një qasje tjetër të Departamentit të Shtetit ndaj Serbisë? Çfarë mund të presim më pas dhe çfarë nëse rezoluta nuk ka sukses?

Joe Wilson: Po theksoj përsëri se sa e rëndësishme do të ishte që Asambleja Parlamentare të mbahej në Shtetet e Bashkuara. Gjithashtu, sa e rëndësishme do të ishte kjo si një nderim për senatorin e ndjerë Lindsey Graham, i cili ishte një mbështetës i madh i popullit të Ukrainës, një mbështetës i madh i popullit të Izraelit dhe, vazhdimisht, një mbështetës i madh i popullit të Tajvanit dhe pavarësisë së tij. Prandaj, ajo që duhet të bëjmë është që unë do të vazhdoj të përpiqem t'i promovoj Shtetet e Bashkuara si vendin e duhur për Asamblenë Parlamentare të OSBE-së në vitin 2027.

Unë nuk jam kundër asnjë vendi tjetër, por shpresoj që çdo vend që do të jetë nikoqir të jetë një vend që do të zvogëlojë çdo ndikim të kriminelit të luftës Putin, çdo ndikim të Partisë Komuniste Kineze dhe çdo ndikim të mullave në Teheran, të cilët kanë planifikuar vdekjen e Amerikës.

REL kërkoi një koment nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së. Ata thanë se delegacioni amerikan i kishte informuar në korrik se Çarlston nuk mund ta organizonte më sesionin e vitit 2027 dhe se më pas Beogradi u zgjodh sipas procedurave të përcaktuara. Çfarë ka ndryshuar që nga ai vendim?

Joe Wilson: Lajmi i mirë është

se kishte shqetësime për kapacitetet e furnizimit me ushqim në Çarlston. Në rregull. Por ne jemi një nga liderët e kuzhinës në Amerikën e Veriut. Ne kemi shpikur karkaleca me miell misri, dhe kështu kemi shërbime ushqimi të nivelit botëror. Dhe kështu, ne arritëm ta zgjidhim këtë çështje. Pastaj u ngrit, në mënyrë legjitime, çështja e stafit. Dhe më pas zbulova - dhe isha shumë mirënjohës që mësova në Hagë - se stafi përbëhet nga vullnetarë të papaguar. Në Çarlston ka shumë, shumë vullnetarë që do të donin të merrnin pjesë. Shumë prej tyre janë studentë në Citadel, Kolegjin Ushtarak të Karolinës së Jugut. Ka gjithashtu një numër studentësh ndërkombëtarë atje që do të mund të punonin si vullnetarë. Dhe pranë qendrës së kongreseve ndodhet Kolegji i Çarlstonit, me 11 mijë studentë. Pastaj më thanë se kishim problem me sigurimin e përkthyesve. Por natyrisht, Çarlston është një qytet ndërkombëtar dhe përkthyesit mund të sigurohen lehtësisht. Dhe më pas mësova se, në fakt, OSBE-ja siguron përkthyesit. Pra, çdo çështje që është ngritur në mënyrë legjitime - jam shumë mirënjohës që çdo çështje mund të adresohet - tregon se, në të vërtetë, Shtetet e Bashkuara janë vendi i duhur për Asamblenë Parlamentare të OSBE-së në vitin 2027.

Pozita ndërkombëtare e Beogradit përcaktohet nga "politika e balancimit" e Aleksandar Vuçiqit. Nëse përgjigjja për takimin e

OSBE-së vitin e ardhshëm në Beograd është, në fakt, "jo", çfarë mendoni? A keni frikë nga reagimi i ardhshëm i Beogradit, duke pasur parasysh se në Ballkan gjithçka është e lidhur dhe gjithçka mund të shkaktojë dëme në marrëdhëniet rajonale?

Joe Wilson: Në të vërtetë, unë do ta shihja këtë si adresim të çështjeve brenda Shteteve të Bashkuara që janë zgjidhur, dhe më pas Beogradi mund të jetë nikoqir në vitin 2028. Por, thelbi është se Shtetet e Bashkuara janë plotësisht të përgatitura për të qenë nikoqire. I jap shumë merita presidentit Donald Trump. Ai vërtet e ka bashkuar Evropën për t'iu kundërvënë kriminelit të luftës Putin dhe për të mbështetur Ukrainën. Jam shumë mirënjohës që një ditë të ketë zgjedhje të drejta dhe të lira në Republikën e Gjeorgjisë, sepse ne e dimë që presidenti, duke punuar me Putinin, i manipuloi zgjedhjet në Tbilisi. Nuk është diçka unike që puna me Putinin po përpiket të zhbëjë ndikimin. Ne e dimë se kishte ndikim të tepruar në Moldavi, por, falë Zotit, populli i Moldavisë u ngrit; ndikim të tepruar në Rumani dhe, përsëri, populli i Rumanisë veproi për të ruajtur pavarësinë e tij. Por kjo varet nga populli i Serbisë që të përcaktojë qeverinë e vet, në mënyrë të drejtë dhe të lirë. Por unë dua që ata të jenë në anën fituese të historisë, që është liria dhe demokracia, jo totalitarizmi, siç dëshmohet nga kriminelit të luftës Putin ose Partia Komuniste Kineze.

‘LULE GJELI’ DHE NEPËRKA MIHALI!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Lumiri i Albinit, Vojsa e Dejonës: Në LDK janë kapur “zotnitë nër veti...”. Në mocionin e fundit, kryetari aktual i LDK-së, Lumi i Xhikës e shpëtoi kokën politike duke u futur nëpër vrimë të gjilpërës deri në kuvendin zgjedhor në vitin 2027, mendo ai. Kështu nuk menduan të pakënaqurit e LDK-së, që të gjithë veteranë të orëve të para që mbledhën 151 nënshkrime për të thirrur kuvendin e jashtëzakonshëm për shkarkimin e Abdixhikut. Në ndërkohë, Vojsa Osmani një frikacake e Guxo-s, si ishi i saj, ish presidente e Kurthit, tash, si seksere e Abdixhikut ka shpenzuar mjete, kafe dhe kohë duke bërë presion te nënshkruesit që ta tërheqin nënshkrimin për ta shpëtuar nga shkarkimi. Pa qenë as anëtare e LDK-së dhe pa pasur

mandat për këtë “ndërmjetësim” klandestin. E ka për karrierën e saj! Po ofrojnë poste ministrore, karrierë në diplomaci, borde, punësime dhe imunitet ligjor për vepra penale sipas modelit Martin Berishaj etj. Me një fjalë nënkupton: “të hysh dhëndër, me halete të Kurthit...”. Madje, pak po angazhohet krahui i Lumirit sa po angazhohet LV-ja për ta shpëtuar Lumirin të cilin po e konsideron si partner serioz për koalicion. Për dallim prej të tjerëve, krahui i Lumirit për Kurthin dhe LV-në është një “fast food” prandaj edhe i përkrahin aq shumë. Krahui i Lumit të Xhikës e ka të theksuar shumë “sindromin e Stokholmit” ndaj Kurthit duke u bindur me përlësi çdo torture ndaj tyre. Abdixhiku i dhënë në mënyrë ephshore ndaj postit, pavarësisht rezultateve, e ka nuhatur se i vetmi person që e rrezikon në të ardhmen ndonëse nuk është në LDK, është Përparim Rama, i biri i Kadrushit dhe nipi i Rrahimit që kanë kontribuar shumë në transicionin emancipues dhe kulturor në Podujevë dhe Llap pas viteve të 60-ta andaj e sulmoi ulët pas koalicionit me PDK-në në Prishtinë anipse Rama e as LDK-ja kurrë nuk do ta fitonin Prishtinën. Jam shumë i sigurt se i vetmi Përparim

Rama ka kapacitet në LDK t’i dalë përballë Kurthit dhe, nëse edhe nuk e mund, së paku e dobëson aq shumë e që e futë në korniza të disiplinimit të detyrueshëm. Në çastin kur kryetari i partisë e humbë përkrahjen e gjysmës së partisë besoj se nuk ka nevojë për kurrfarë kuvendi, duhet të largohet dhe t’i ndihmojë partisë. Qartazi, ky refleks nuk reagon te ne prandaj kemi këso situata ku, sipas Luigjit - mbretit Diell, partia jam unë! Uroj që LDK-ja të mos përçahet dhe këtu kontributin më të madh mund dhe duhet ta japë Abdixhiku. Të presim edhe një ditë.

Lule pula dhe gjeli i plehut: Nëse krahasohet me kujdes dhe nga distanca mënyra se si LV-ja erdhi në pushtet dhe si po e mbanë pushtetin, atëherë e gjejmë një copy paste se si Adolf Hitler erdhi në pushtet në Gjermani dhe se si e mbajti atë pushtet. Këtu, Nikolo Makiaveli del të jetë një amater kurse “Të mençurit e Sionit” i ngajnë një karikaturë të Simpsonsve! Ose, krahasuar me Cosa Nostran dhe N’draghetën në Itali. Nëse Cosa Nostra e kishte një kodeks nderi, N’dragheta nuk e kishte asnjë! Kështu po sillen edhe gjelat e plehut të LV-së me një gjuhë

urrejtjeje të paparë dhe padëgjuar deri më tani. Kanë shkatërruar çdo komunikim normal në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Luginë, Mal të Zi dhe diasporë. E pabesueshme deri ku ka arritur urrejtja; antikombëtarët dhe bashkëpunëtorët e Serbisë sot e luftojnë UÇK-në dhe çlirimtarët. Ata që prehin e Arkanit e kanë pasur djep, sulmojnë vlerat e luftës dhe e sulmojnë Përparim Ramën. Njëri që e udhëheq mendermethënë kronikën e m.it, ekskluzivisht, nga interesi ruso - serb sulmon çlirimtarët, ish të burgosurit politik dhe çdokënd që nuk ia “kruan bishtin Albinit”. Në Kosovë kurrë nuk ka pasur njerëz më të këqij, më grykësa, më hajna, gënjeshtarë, mashtrues, ma injorantë dhe politikisht analfabetë si dhe antikombëtarë se tani. Hiçe këtu Albinin apo Albin Makiavellin. Kur t’i dëgjosh çka flasin, vetëm duhet ta qëllosh se cili është më injorantë, asgjë tjetër! Me këta nuk bëhet koalicion, nuk bëhet asgjë e hajrit. Opozita nuk duhet të tredhet sikur deri tani, duhet t’ia votojë presidentin dhe t’ia kërcet protestave. Në këtë mënyrë rrëzohet Kurthi apo detyrohet të sillet si njeri normal. Në këtë mënyrë nepërka e gjuhës së urrejtjes, Dejona Mihali, ose dërgohet në

Burgun e Lipjanit ose dorëzohet në Greqi. Në këtë mënyrë dekriminalizohet krahui mihalist i AKI-së. Në këtë mënyrë normalizohet komunikimi midis shqiptarëve dhe dekriminalizohet gjuha e urrejtjes. Nëse jo, atëherë, në vend të ligjit do të zbatohet e drejta e individit sipas parimit: “dy duar për një kokë...”. Madje është e habitshme si nuk ka shpërthyer situata më herët. Është një rrethanë me fat për Kosovën dhe qytetarët e saj; “po të ishin trima sa janë të poshtër klika antikombëtare që ka kapur çdo gjë, moti do të shpërthente situata...”. Frerët janë në duart e Kurthit. A do të shkojë qerrija e quajtur Kosovë në rrugën e duhur apo do të përfundojë në greminëne urrejtjes, varet nga Kurthi, kryesisht por as opozita nuk do të jetë e amnistuar. Sa shumë i mungojnë sot Kosovës Baca Adem Demaçi, Adem Jashari, Rexhep Mala, Zahir Pajaziti, Fehmi dhe Xhevdet Lladrovci dhe heronjtë e tjerë. Me ta do ta kishim një situatë tjetër, pa ta e kemi këtë situatë ku antivlerat hedhin valle. Asnjëherë shqiptarë! Demin e tërbuar Albin Kurthi mund ta ndalin vetëm dy toreadorë, Hashim Thaçi dhe Përparim Rama!

SHQIPËRIA, NDËR VENDET ME AJRIN MË VDEKJEPRURËS NË EVROPË

TIRANË, 29 KORRIK - Shqipëria është ndër vendet evropiane me pasojat më të rënda shëndetësore nga ndotja e ajrit. Të dhënat më të fundit të Eurostat-it tregojnë se vendi regjistron 129 vdekje të parakohshme për 100 mijë banorë, të lidhura me ekspozimin ndaj grimcave të imëta në ajër. Me këtë tregues, Shqipëria renditet e katërta në Evropë, pas Maqedonisë së Veriut, Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë. Niveli është më shumë se tri herë mbi mesataren e Bashkimit Evropian, e cila në vitin 2023 ishte 41 vdekje të parakohshme për 100 mijë banorë. Treguesi i Eurostat-it mat numrin e vdekjeve të parakohshme nga ekspozimi ndaj grimcave PM2.5, të cilat kanë diametër më të vogël se 2.5 mikrometra. Për shkak të përmasave shumë të vogla, këto grimca depërtojnë thellë në mushkëri dhe mund të kalojnë edhe në qarkullimin e gjakut. PM2.5 krijohen kryesisht nga djegia e lëndëve të ngurta për ngrohje, aktivitetet industriale, transporti rrugor dhe djegia e mbetjeve. Ekspozimi ndaj tyre nuk lidhet vetëm me praninë e industrisë së rëndë, por edhe me mënyrën e ngrohjes, cilësinë e karburanteve, moshën e automjeteve dhe kushtet urbane që favorizojnë grumbullimin e ndotësve.

Rreziku për shëndetin

Sipas specialistëve, grimcat PM2.5 janë ndër ndotësit më problematikë për shëndetin.

Pneumologu Jul Bushati shpjegon për Faktos se rreziku lidhet me aftësinë e këtyre grimcave për të depërtuar në pjesët më të thella të sistemit respirator. “Grimcat PM2.5 janë aq të vogla sa kalojnë në alveolat pulmonare dhe mund të hyjnë në qarkullimin e gjakut”, shprehet Bushati. Sipas tij, ekspozimi ndaj niveleve të larta të PM2.5 rrit rrezikun për inflamacion të rrugëve të frymëmarrjes, përkeqësim të astmës, sëmundjes pulmonare obstruktive kronike (SPOK), si dhe lidhet me rrezik më të lartë për kancer të mushkërive dhe sëmundje kardiovaskulare. “Ekspozimi i përditshëm ndaj ndotjes së ajrit është si një investim negativ në shëndet. Dëmtimi akumulohet ngadalë dhe mund të shfaqet pas viteve si astmë, bronkit kronik, SPOK apo sëmundje kardiovaskulare”, thotë ai.

Tirana dhe Elbasani, qytetet me ndotjen më të lartë

Të dhënat ndërkombëtare përputhen edhe me raportimet e institucioneve shqiptare. Agjencia Kombëtare e Mjedisit evidenton Tiranën dhe Elbasanin si qytetet me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit në vend. Sipas AKM-së, në këto dy qytete janë regjistruar tejkallime të normave për grimcat PM10, ndërsa Elbasani rezulton qyteti i



vetëm ku është tejkalluar edhe norma për dyoksidin e azotit (NO₂), një ndotës që lidhet kryesisht me gazrat e automjeteve dhe aktivitetin industrial. Agjencia e Mjedisit pranon se burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Shqipëri janë trafiku rrugor, aktivitetet e ndërtimit dhe përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje gjatë dimrit.

Trafiku dhe ndërtimi

Një faktor i rëndësishëm në ndotjen urbane në Shqipëri është rritja e numrit të mjeteve në qarkullim. Sipas INSTAT, në fund të vitit 2025 në Shqipëri ishin të regjistruara mbi 1 milionë mjete rrugore. Vetëm në një vit, numri i mjeteve u rrit me

9,3%. Dhe problemi nuk lidhet vetëm me numrin e automjeteve, por edhe me karakteristikat e flotës. Sipas INSTAT, 55,3% e mjeteve rrugore janë prodhuar gjatë periudhës 2000-2010, ndërsa autoveturat me moshë 11-20 vjet përbëjnë 45,7% të totalit. Nafta mbetet karburanti dominues. Vitin e shkruar, 72,1% e autoveturave funksiononin me naftë. Ndërkohë, numri i autoveturave elektrike është rritur me 91,2% krahasuar me vitin 2024, por mbetet ende një pjesë e vogël e flotës totale. Një tjetër burim ndotjeje që është rritur ndjeshëm vitet e fundit është ndërtimi. Sipas të dhënave të INSTAT, të përlogaritura nga Faktos, në pesë vitet e fundit janë dhënë rreth 7 mijë leje ndërtimi në

të gjithë vendin. Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj, e ka cilësuar cilësinë e ajrit si një nga kapitujt më sfidues në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian. Në maj të këtij viti, gjatë prezantimit të Planit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike 2026-2036, Jaupaj deklaroi se Ministria e Mjedisit ka nisur bashkëpunimin me Bankën Botërore për financimin e një projekti të plotë monitorimi të cilësisë së ajrit. Projekti parashikon ngritjen e një qendre kombëtare monitorimi dhe vendosjen e stacioneve të reja sipas standardeve të Agjencisë Evropiane të Mjedisit. Objektivi është që deri në vitin 2028 Shqipëria të ketë një sistem të plotë monitorimi të cilësisë së ajrit.

Sot vendoset për fatin e Abdixhikut në krye të LDK-së

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, e ka thirrur për të enjten, në orën 18:00, Kuvendin e Jashtëzakonshëm të partisë, në të cilin pritet të testohet besimi brendapartiak ndaj tij. LDK-ja ka lëshuar një komunikatë për medie, duke njoftuar opinionin publik dhe

anëtarësinë, se Abdixhiku, “në ushtrim të kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara me Statutin e partisë, ka marrë vendim për thirrjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas përfundimit të procedurave statutare të verifikimit të kërkesës së paraqitur nga delegatët e Kuvendit”. “Në funksion të

garantimit të rregullsisë, ligjshmërisë dhe integritetit të procesit, Sekretariati i Përgjithshëm i LDK-së ka kryer verifikimin e të gjitha nënshkrimeve të dorëzuara në përputhje me dispozitat e Statutit. Nga ky proces është konstatuar se është përmbushur kriteri statutar prej së paku një të tretës (1/3) të delegatëve të Kuvendit, të

nevojshëm për thirrjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm. Në zbatim të detyrimeve statutare dhe pa asnjë vonesë pas përfundimit të procesit të verifikimit, kryetari i LDK-së ka vendosur që Kuvendi i Jashtëzakonshëm të mbahet të enjten, më 30 korrik 2026, me fillim nga ora 18:00”, është thënë në komunikatën e LDK-së.



ANKETA E FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE TË UP-së ZBULON NEVOJAT E TREGUT TË PUNËS NË FUSHËN E KOMPJUTERIKES

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 KORRIK - Një anketë e realizuar këtë vit nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në FIEK të UP-së, nën mbikëqyrjen e profesorit Kadri Sylejmani, ka shfaqur nevojat e industrisë dhe tregut të punës në Kosovë në fushat e kompjuterikes, teknologjisë së komunikimit dhe informacionit dhe mjeteve të inteligjencës artificiale. Anketa është zhvilluar me 228 profesionistë dhe drejtues të lartë në industrinë kompjuterike të vendit, shumica nga të cilët janë zhvillues seniorë, udhëheqës ekipesh ose drejtues ekzekutivë të kompanive. Nga anketimi i personave që janë pjesë shumë e rëndësishme e kësaj industrie vazhdimisht në

zhvillim, kanë dalë nevojat për profesionistë të ndryshëm. Më së shumti në industrinë kompjuterike, sipas anketës, po kërkohen zhvillues të softuerëve dhe DevOps, një kombinim mes zhvilluesve softuerikë dhe operacioneve të teknologjisë informative. Pavarësisht kërkesës së madhe për profesionistë të tillë, mbi gjysma e drejtuesve në industrinë kompjuterike kanë treguar se kanë vështirësi për t'i gjetur ekspertët e nevojshëm. Aktualisht në tregun e punës më së shumti po vlerësohen njohuritë për dizajn softuerësh, mjete të inteligjencës artificiale dhe sisteme inteligjente. Më lehtë për të gjetur punë e kanë ata që njohin teknologjitë e uebit React e Node dhe gjuhën programuese Python. Disiplinat me zhvillimin më të



shpejtë janë ato që lidhen me sigurinë kibernetike, inteligjencën artificiale dhe cloud computing, derisa të njëjti profesionist më së shumti

çmohen aftësitë e punës në ekip dhe të menduarit kritik. Gjysma e të anketuarve nga industria kompjuterike mendojnë se pagat në këtë sektor

sillen nga 1000 deri në 1500 euro, ndërsa çereku i pjesëmarrësve të anketës besojnë se këto paga janë deri në 2000 euro në muaj. Drejtuesit e industrisë rekomandojnë më shumë praktikë reale për studentët, përditësim të kurrikulave në harmoni me industrinë dhe fitim të aftësive të komunikimit për ekipe dhe klientë ndërkombëtarë. Universiteti i Prishtinës në kuadër të angazhimeve të përditshme e të vazhdueshme për të qenë një universitet i kohës në të cilën po jetojmë, i kushton rëndësi të jashtëzakonshme përgatitjes së studentëve për epokën e inteligjencës artificiale. Për këtë qëllim u krijua edhe Qendra për Inteligjencë Artificiale (AIUP), drejtor i së cilës është zgjedhur profesori Kadri Sylejmani.

INFLACIONI GODET PELETIN, ISH-KREU I OEK-ut: ÇMIMI U RRIT 59 % BREND A NJË VITI



PRISHTINË, 29 KORRIK - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës ka reaguar për rritjen e çmimit të peletit, duke vlerësuar se mungesa e stabilitetit politik dhe zhvillimet ekonomike po ndikojnë drejtpërdrejt në standardin e jetesës së qytetarëve. Sipas tij, Kosova po përballlet me një inflacion të lartë që po reflektohet në rritjen e çmimeve dhe në uljen e fuqisë blerëse. Ai thekson se, përveç sfidave me furnizimin me

energji elektrike, shqetësues mbetet edhe rritja e kostos së alternativave për ngrohje. Në reagimin e tij ai thekson se çmimi i një toni pelet është rritur nga 220 euro në vitin 2025 në 350 euro në vitin 2026, ose 130 euro më shumë që, sipas llogaritjeve, përfaqëson një rritje prej 59.09-përqindësh. Ai sqaron se kjo përqindje paraqet inflacionin specifik të peletit dhe nuk duhet të ngatërrohet me inflacionin e përgjithshëm, i

cili, sipas tij, është rreth 7.5 për qind. Sipas tij, rritja e çmimit të peletit ndikohet nga faktorë si kërkesa sezonale, kostot e prodhimit të drurit dhe zhvillimet në tregun e energjisë. Në përfundim, ish-kryetari i OEK-së vlerëson se rritja mbi 59 për qind e çmimit të peletit brenda një viti përbën një goditje të rëndë për buxhetin e familjeve të Kosovës që përdorin këtë lëndë për ngrohje gjatë dimrit.

FKEE koordinon me Bankën Botërore dhe BE-në zbatimin e projekteve të efijencës së energjisë

PRISHTINË, 29 KORRIK - Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë ka zhvilluar një takim pune me përfaqësues të Bankës Botërore dhe Bashkimit Evropian në kuadër të koordinimit të aktiviteteve për zbatimin e projekteve të efijencës së energjisë në sektorin publik. Gjatë takimit u diskutuan komponentët kryesorë të projektit, struktura e

implementimit, rolet dhe përgjegjësitë e palëve si dhe modalitetet operacionale për zbatimin e aktiviteteve. Po ashtu, u trajtuan çështje që lidhen me menaxhimin financiar, prokurimin, kërkesat për pajtueshmëri, menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale, angazhimin e palëve të interesit, mekanizmat e trajtimit të ankesave si dhe korniza e rezultateve dhe

monitorimit të projektit. Takimi shërbeu për t'i harmonizuar hapat e ardhshëm dhe për të siguruar një koordinim të ngushtë ndërmjet FKEE-së, Bankës Botërore dhe Bashkimit Evropian, me synim zbatimin sa më efikas të investimeve prioritare që do të kontribuojnë në rritjen e efijencës së energjisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.



TREGU I BE-së MBETET I MBYLLUR PËR QUMËSHTIN E KOSOVËS

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kosova prodhon qumësht, djathë, kos e produkte të tjera të bulmetit. Fabrikat kanë investuar në teknologji, fermerët kanë rritur prodhimin, ndërsa shteti ndan miliona euro subvencione çdo vit për ta zhvilluar sektorin. Megjithatë, produktet e qumështit nga Kosova nuk mund të shiten në tregun më të madh në Evropë. Jo sepse nuk plotësojnë domosdoshmërisht standardet e cilësisë apo sepse mungojnë kapacitetet prodhuese, por sepse Kosovës i mungon një dokument kyç që i hap dyert e Bashkimit Evropian: certifikata veterinare e njohur nga BE-ja. Për pasojë, industria e qumështit mbetet e kufizuar në tregun vendor prej rreth 1.6 milion banorësh dhe në disa vende të rajonit. Përfaqësuesit e sektorit paralajmërojnë se kjo po krijon një efekt zinxhiror: fermerët përballen me teprica të qumështit, fabrikat nuk i shfrytëzojnë kapacitetet e tyre dhe mundësitë për rritje mbeten të bllokuara. “Problemet brenda Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë kanë bllokuar eksportin e produkteve ushqimore. Neve na duhet vetëm certifikata, sepse kapacitete kemi”, thotë për Radion Evropa e Lirë Gani Durmishi, nga Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës. Sipas tij, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ende nuk i ka përmbushur kriteret e Bashkimit Evropian për t’u autorizuar të lëshojë certifikata veterinare të vlefshme për eksport.

Çfarë është certifikata veterinare dhe pse është e rëndësishme?

Certifikata veterinare është dokumenti zyrtar që dëshmon se kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, si qumështi, djathi, mishi dhe vezët, i plotësojnë standardet e shëndetit publik dhe të sigurisë ushqimore të Bashkimit Evropian. Por, një shtet nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë vetëm me vendim të institucioneve të veta. Ai duhet të ketë një sistem veterinar të njohur dhe të vlerësuar nga Bashkimi Evropian. Radio Evropa e Lirë pyeti AUV-në se cilat janë arsyet konkrete që Kosova ende nuk është autorizuar të eksportojë produkte me origjinë shtazore në Bashkimin Evropian, por nuk mori përgjigje. Përgjigje nuk dha as Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë lidhur me kriteret që Kosova ende nuk i ka përmbushur dhe afatin e mundshëm për autorizimin e eksporteve. Ish-kryeshefi ekzekutiv i AUV-it, Valdet Gjinovci, shpjegon se kjo nënkupton një zinxhir të tërë kontrolli: identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, mbikëqyrjen e sëmundjeve, kontrollin e ushqimit për kafshë, inspektimin e fermave dhe fabrikave, analizat laboratorike, si dhe kontrollin gjatë përpunimit, paketimit dhe shpërndarjes së produkteve. Sipas tij, Kosova ka bërë përparim, por ende nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat. “Gjendja në terren nuk është e vështirë për t’u përmirësuar, sepse janë bërë investime. Megjithatë, ka pengesa të tjera. Kosova nuk është anëtare e Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, prandaj nuk përfiton nga ekspertiza dhe programet e saj. Përveç kësaj, duhet të harmonizohen ligjet dhe sistemi veterinar me rregulloret e BE-së”, thotë Gjinovci.

A janë gati kompanitë e Kosovës të eksportojnë?

Përfaqësuesit e industrisë së qumështit thonë se problemi nuk është te prodhuesit, por te mungesa e qasjes në tregun evropian. Sipas Durmishit, shumica e fabrikave kanë kapacitetet, teknologjinë dhe standardet e nevojshme për të konkurruar në tregjet e Bashkimit Evropian, por nuk mund t’i shfrytëzojnë ato plotësisht. “Disa qumështore në Kosovë nuk punojnë në tri ndërrime vetëm sepse nuk kanë treg. Ka fabrika që mund të përpunojnë rreth 100 mijë litra qumësht në ditë. Nëse llogariten vetëm dhjetë të tilla, kapaciteti arrin në një milion litra në ditë. Por, sot pothuajse asnjëra nuk punon 24 orë. Shumica punojnë vetëm tetë, e disa edhe katër orë në ditë”, thotë Durmishi. Sipas tij, interesimi nga tregjet evropiane tashmë ekziston. “Disa kompani nga Gjermania dhe Zvicra na kanë thënë: vetëm rregulloni dokumentacionin dhe ne do t’i marrim produktet. Edhe përpunuesit janë të gatshëm ta rrisin prodhimin”, shton Durmishi. Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë tregojnë se vetëm gjatë vitit 2024, industria e qumështit në Kosovë prodhoi produkte me vlerë prej 135.2 milionë eurosh. Megjithatë, kjo mjafton për të mbuluar vetëm rreth 66 për qind të nevojave të tregut vendor, ndërsa pjesa tjetër plotësohet përmes importit. Sipas Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në Kosovë janë të regjistruara 48



objekte të miratuara për përpunimin dhe paketimin e qumështit. Edhe ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ismet Mulaj, vlerëson se një pjesë e prodhuesve kosovarë tashmë i kanë arritur standardet që kërkojnë për eksport. Sipas tij, hallka që mungon nuk janë bizneset, por institucionet. “Ka kompani që kanë bërë investime të mëdha, kanë marrë asistencë profesionale nga ekspertë evropianë dhe kanë ndërtuar kapacitetet e nevojshme. Por, nuk mund të eksportojnë, sepse institucioni përgjegjës ende nuk i ka përmbushur standardet e kërkuara. Kjo është pasojë e mungesës së vullnetit politik ndër vite. Ky proces do të mund të përfundonte brenda dy vjetësh”, thotë Mulaj për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, kjo situatë ka krijuar një pabarazi të vazhdueshme tregtare. Ndërsa Kosova importon sasi të konsiderueshme të produkteve të qumështit, eksporti mbetet i kufizuar tërësisht në tregjet e rajonit. “Për sa kohë që tregu evropian mbetet i mbyllur, industria vendore nuk mund të zhvillohet me ritmin që ka potencial. Hapja e këtij tregu do të nënkuptonte më pak import, më shumë prodhim vendor dhe një ekonomi më konkurruese”, thotë ai.

Çfarë tregojnë shifrat?

Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se eksporti i produkteve të qumështit është i kufizuar në vendet e rajonit. Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, Kosova eksportoi produkte të qumështit kryesisht në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi, në vlerë prej rreth 478 mijë eurosh. Nga kjo shumë, eksporti i kosit - një prej produkteve më të shitura pas qumështit - arriti në rreth 90 mijë euro. Në të njëjtën periudhë, importi ishte shumëfish më i lartë.

Në tregun e Kosovës hynë produkte të qumështit nga vendet e rajonit dhe Bashkimi Evropian në vlerë prej mbi 12 milionë eurosh, ndërsa vetëm importi i kosit kaloi 2 milionë euro. Edhe shifrat e vitit 2024 tregojnë të njëjtën priirje. Kosova importoi produkte të qumështit në vlerë prej rreth 31 milionë eurosh, ndërsa eksporti ishte vetëm rreth 331 mijë euro. Ky raport, sipas njohësve të ekonomisë, nuk pasqyron domosdoshmërisht mungesë të prodhimit apo të interesimit për produktet kosovare, por kufizimet që industria ka në qasjen në tregje më të mëdha. Mulaj thotë se mungesa e mundësisë për të eksportuar në Bashkimin Evropian e detyron industrinë vendore të mbështetet pothuajse vetëm në tregun e Kosovës dhe në një pjesë të vogël të tregut rajonal. “Për sa kohë që nuk hapen tregjet e reja, importi do të vazhdojë të dominojë. Kjo krijon një debalancë tregtare që e dëmton prodhimin vendor dhe kufizon zhvillimin e industrisë”, thotë ai. Sipas tij, hapja e tregut evropian nuk do të ndikonte vetëm në rritjen e eksporteve, por edhe në uljen e varësisë së Kosovës nga importi i produkteve të qumështit.

Çfarë humbet ekonomia?

Për Mulajn, pasojat nuk ndihen vetëm nga kompanitë përpunuese. Ato prekin të gjithë zinxhirin e prodhimit - nga fermerët deri te buxheti i shtetit. “Qeveria e Kosovës çdo vit ndan miliona euro përmes granteve dhe subvencioneve për industrinë e qumështit me synim rritjen e prodhimit vendor. Por, nëse nuk siguron tregje ku ai prodhim shitet, investimet nuk japin efektin e plotë”, thotë ai. Sipas tij, tregu i Kosovës është shumë i vogël

për të përthithur një rritje të vazhdueshme të prodhimit. Pa mundësi eksporti, kompanitë nuk kanë arsye të zgjerojnë kapacitetet, ndërsa fermerët përballen me kufizime në shitjen e qumështit. Edhe Durmishi beson se hapja e tregut evropian do ta ndryshonte rrënjësisht industrinë. “Do të rritej numri i fermerëve, i punëtorëve dhe i fabrikave që punojnë me kapacitet të plotë. Do të rritej qarkullimi dhe fitimi i kompanive. Ne mund të konkurrojmë me cilësi dhe standarde. Ajo që na mungon, është mbështetja institucionale”, thotë ai.

Premtimet për eksport dhe pritja për veprime

Hapja e tregut të Bashkimit Evropian për produktet e qumështit është një nga synimet që Qeveria e Kosovës e ka përfshirë në programin e saj. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, është zotuar se mandati i ardhshëm do të jetë mandat i prodhimit, zhvillimit ekonomik dhe vetëqëndrueshmërisë. Në programin qeverisës të prezantuar për zgjedhjet e 7 qershorit, ai ka premtuar mes tjerash: rritjen e eksporteve, zhvillimin e kapaciteteve për përpunimin e mishit dhe qumështit, si dhe standardizimin e produkteve bujqësore. Po ashtu, është zotuar të mbështesë investimet për certifikimin e prodhimeve sipas standardeve evropiane, me qëllim që fermerët dhe kompanitë kosovare të fitojnë qasje në tregjet rajonale dhe ato të BE-së. Megjithatë, Zyra e Kryeministrit në detyrë nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se kur do të nisë zbatimi i ndonjë mase konkrete për përmbushjen e këtyre zotimeve dhe për avancimin e procesit që do t’i mundësonte Kosovës eksportin e produkteve me origjinë shtazore në BE.

LARA COLTURI NDEROHET NDËRSA KOMUNITETI SHQIPTAR I SKIVE FESTON NË TIRANË



Nga Darka Sefcik
STARNOVA

SkiRacingMedia

Tridhjetë e shtatë gradë Celsius, palma të larta dhe pije të ftohta pranë pishinës në fund të korrikut në Tiranë — në pamje të parë, asgjë në këtë ambient nuk të krijonte përshtypjen e një feste kushtuar sporteve dimërore. Por kushdo që e njeh Elvis Toçin, presidentin e Federatës Shqiptare të Skive, e di se prej tij mund të presësh gjithmonë të papriturën.

Teksa organizatorët shkarkonin blloqe të mëdha akulli nga një kamionçinë dhe përgatiteshin për Ski Excellence Night, Toçi shpjegoi se federata e kishte krijuar këtë mbërmje për të nderuar të gjithë komunitetin e skive.

“Kemi përgatitur shumë çmime, sepse në një vend ku skitë janë ende një sport pak i njohur, duhet shumë përpjekje, punë e palodhur dhe pasion për ta zhvilluar këtë sport,” tha Toçi.

Ai i përshkroi anëtarët e federatës si njerëz që e duan ski-

jimin dhe besojnë se Shqipëria mund të bëhet një pjesë e konsoliduar e komunitetit ndërkombëtar të skive alpine. “Po fitojmë përvojë dhe po zhvillohemi me shpejtësi.” Gjatë gjithë mbërmjes u ndanë çmime për sportistë dhe përfaqësues të sportit, turizmit, medias dhe komunitetit ndërkombëtar të skive. Toçi dhe anëtarët e ekipit të tij mediatik dorëzuan trofe të punuar me dorë përpara një sfondi të stilizuar si “Audi FIS Ski World Cup Tirana”.

ARTIKULLI ORIGINJAL:

Lara Colturi Honored as Albania's Ski Community Celebrates in Tirana

Lara Colturi mori çmimin “Sportistja më e Mirë e Vitit”, pasi sezonin e kaluar arriti katër podiume në Kupën e Botës dhe u rendit e 10-ta në disiplinën e sllallomit në Lojërat Olimpikë.

“Është një nder i jashtëzakon-

shëm, sepse ky është një çmim vërtet i rëndësishëm. Jam shumë krenare për gjithçka që kam arritur deri tani në karrierën time dhe kjo do të thotë shumë për mua. Më është dashur të sakrifikoja shumë dhe të punoj jashtëzakonisht fort. Falënderoj familjen time për mbështetjen dhe, sigurisht, federatën, sepse falë tyre jam sot këtu,” tha Colturi duke mbajtur në duar trofeun.

Çmimi “Trajnerja më e Mirë e Vitit” iu dha nënës së Larës, Daniela Ceccarelli, kampione olimpike në super-G në vitin 2002. Ndërsa Denni Xhepa, tre herë olimpist për Shqipërinë, u shpall “Sportisti më i Mirë i Vitit”.

Colturi kaloi një pjesë të pushimeve verore duke eksploruar Shqipërinë me një kamper.

“Përshkuam gjithë vendin nga veriu në jug për 10 ditë dhe do të doja të kishim pasur më shumë kohë. Shqipëria është vërtet e bukur. E dua këtë vend, nga malet e larta deri te plazhet mahnitëse. Njerëzit janë jashtëzakonisht të sjellshëm dhe ua rekomandoj të gjithëve ta vizitojnë Shqipërinë.”

Edhe pse ka lindur në Itali, Colturi zgjodhi të përfaqësojë Shqipërinë. Ajo tha se tifozët shqiptarë po e njohin gjithnjë e më shumë në publik dhe shpesh e ndalojnë për ta përshëndetur.

“Po, ende po mësohem me këtë. Ndonjëherë njerëzit afrohen dhe më pyesin nëse mund të flasim me mua, sepse nuk janë të sigurt. Por unë jam njeri i hapur, nuk kafshoj,” tha ajo duke qeshur.

Një kapitull i ri me skitë HEAD

Colturi së fundmi njoftoi se sezonin e ardhshëm do të garojë me pajisje të markës HEAD.

“Është një kapitull i ri, diçka krejt ndryshe, dhe do të shohim si do të shkojë. Pas testeve në Kvitfjell vendosa ta bëj këtë hap. Por kemi ende shumë punë përpara, fillimisht në Saas-Fee në fund të korrikut dhe më pas në Zelandën e Re, ku do të vazhdojmë përgatitjet.”

Programi i vogël shqiptar i Kupës së Botës stërvitet shpesh së bashku me sportistë të ekipeve më të mëdha kom-

bëtare, gjë që i lejon Colturit dhe stafit të saj të ndajnë ambientet dhe burimet e stërvitjes.

“Është shumë bukur të shohësh se si ndihmojmë njëri-tjetrit në nivel ndërkombëtar. Jemi miq. Po, garojmë kundër njëri-tjetrit, por sapo gara përfundon, gjithçka mbaron aty. Pastaj mund të dalim për darkë së bashku ose edhe të kalojmë një pjesë të pushimeve bashkë. Kjo është një nga gjërat më të bukura të sportit tonë.”

Colturi tha se ekipi i saj ka krijuar një marrëdhënie veçanërisht të fortë me sportistët zviceranë dhe planifikon të stërvitet sërisht me ta.

Drejtuuesi i Swiss-Ski vlerëson përparimin e Shqipërisë. Mes të ftuarve specialë të mbërmjes ishte edhe Diego Zueger, bashkëdrejtor ekzekutiv i Swiss-Ski.

“Është një nder i madh të jem këtu dhe jam vërtet i impresionuar nga ajo që pashë sonte. Në Zvicër praktikisht lindim me ski në këmbë. Mësojmë të bëjmë ski përpara se të mësojmë të ecim. Pikërisht për këtë arsye, ajo që keni arritur me Larën dhe



sportistët tuaj të tjerë është vërtet e jashtëzakonshme dhe shumë mbresëlënëse.” Federata nderoi gjithashtu brezin e ardhshëm të skiatorëve shqiptarë. Me mbështetjen e një partneri çek, dy sportistëve të rinj iu dhuruan ski të reja. Edhe pse fëmijët shqiptarë nuk lindin me ski në këmbë, federata shpreson që gjithnjë e më shumë prej tyre të kenë mundësinë ta zbulojnë këtë sport.

Nick Fellows, drejtori i FIS TV, mori çmimin “Voice of the Slopes” për punën e tij në transmetimin e garave ndërkombëtare të skive alpine.

Si t’ia shpjegosh garat e skive një publiku të ri

Edhe ekipi shqiptar i transmetimit televiziv u vlerësua me çmim. Komentatori Etrit Xhuglini tha se transmetuesit përballen me një sfidë të veçantë: t’ua prezantojnë skitë alpine shikuesve të një vendi mesdhetar, ku shumë njerëz kanë pak ose aspak përvojë me këtë sport.

“Ata duan ta shohin Larën në podium,” tha Xhuglini duke qeshur.

“Jo, seriozisht, unë i dua sportet dhe u gëzova shumë kur Elvisi më ftoi t’i bashkoheja këtij projekti. Më pëlqen singlerisht. Meqë shumë njerëz

këtu nuk dinë shumë për skitë, ne përqendrohemi më tepër te emocionet sesa te detajet teknike.”

Transmetimet shpjegojnë

sportin dhe ofrojnë kontekst, ndërsa njëkohësisht prezantojnë Shqipërinë para audiencës ndërkombëtare të skive alpine.

“Gjatë intervistave me

sportistët kemi gjithashtu mundësinë të prezantojmë kulturën shqiptare dhe vendin tonë para botës së skive. Njerëzit kënaqen kur shohin tifozët shqiptarë që mbështesin sportistët tanë në mbarë botën, ndaj krahas garave ne i përfshijmë ata edhe në reportazhet dhe intervistat tona.”

Xhuglini tha se kjo qasje ka

Një vlerësim për tifozët

Sipas Toçit, t’u japësh tifozëve një vend në qendër të vëmendjes është thelbësore për këtë sport.

“Sporti pa tifozë është i vdekur. A mund ta imagjinoni Kupën e Botës në futboll pa tifozë? Tifozët krijojnë spektaklin dhe sportistët performojnë më mirë falë tyre. Prandaj, në çdo takim të FIS-it, unë vazhdoj të theksoj



ndihmuar në rritjen e interesit të publikut për skitë alpine, edhe përmes përmbajtjes që ekipi televiziv publikon në rrjetet sociale.

se, krahas të gjithë aktorëve të tjerë të rëndësishëm, tifozët duhet të jenë një forcë e fuqishme që e shtyn përpara motorin e sportit tonë.”


Në përputhje me këtë filozofi, Ski Excellence Night nderoi mbështetësit e Larës, tifozët shqiptarë dhe klubet ndërkombëtare të tifozëve me çmimin “Spirit of the Slopes”, që vlerëson pasionin dhe atmosferën që ata sjellin në garat e skive alpine.

Ceremonia ofroi një pamje të qartë të mënyrës se si komuniteti shqiptar i skive po vazhdon të rritet, pavarësisht traditës së kufizuar të vendit në garat ndërkombëtare të skive alpine. Sukses i Larës ka krijuar një pikë referimi të dukshme, por mbrëmja nxori në pah edhe rolin e transmetuesve, zyrtarëve, partnerëve, sportistëve të rinj dhe tifozëve që po kontribuojnë për zhvillimin e këtij sporti.

Shqipëria, Tirana dhe ngrohësia e njerëzve të saj lanë një përshtypje të paharrueshme tek unë. Gjeta një vend plot energji pozitive, buzëqeshje, ngjyra dhe një dëshirë të sinqertë për ta ndarë kulturën e tij me botën e skive.

Në fund, Ski Excellence Night ishte shumë më tepër sesa një ceremoni ndarjeje trofesh. Ishte një festë e një komuniteti të bashkuar nga besimi se skitë alpine mund të hedhin rrënjë edhe në vende ku askush nuk do ta kishte pritur. / SkiRacing Media – Bota.al





DRITA SIGURON KUALIFIKIMIN DRAMATIK NË RAUNDIN E TRETË TË UEFA CONFERENCE LEAGUE

PRISHTINË, 29 KORRIK - FC Drita është kualifikuar në raundin e tretë të UEFA Conference League, pasi ka mposhtur Floriana FC me rezultat 2:1 pas vazhdimëve, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Pas barazimit 1:1 në takimin e parë në Maltë, skuadra gjilanasë ka siguruar kalimin më tutje falë një paraqitjeje të fortë dhe një përmbysjeje dramatike në fund të ndeshjes.

Floriana ka kaluar në epërsi në minutën e 40, kur Paul Mbong ka realizuar një gol të bukur për 1:0. Drita reagoi me këmbëngulje dhe, pasi krijoi disa raste të mira shënimi, arriti të barazojë në minutën e 87. Jorgo Pëllumbi ka realizuar për 1:1, duke e dërguar sfidën në vazhdimë.

Një rol vendimtar në



kualifikimin e Dritës pati Raddy Ovouka, i cili është inkuadruar në lojë në minutën e 60 nga trajneri Zekirija Ramadani. Ovouka ka asistuar te goli i barazimit, ndërsa në fillim të vazhdimit të parë

aksioni i tij detyroi mbrojtësin e Florianas të shënonte autogol, duke i dhënë Dritës epërsinë dhe fitoren 2:1. Skuadra kampione e Kosovës e administroi me sukses epërsinë deri në fund, duke

vulosur kualifikimin në raundin e tretë të kësaj gare. Në fazën e ardhshme Drita do të përballlet me Tre Fiori nga San Marino. Ndeshja e parë do të zhvillohet më 6 gusht në San Marino, ndërsa ndeshja e kthimit një javë më vonë në Kosovë.

Ademi uron Dritën për kualifikimin në raundin e tretë të Conference League

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka uruar FC Dritën për kualifikimin në raundin e tretë të UEFA Conference League. Ai ka thënë se lojtarët e Dritës kanë treguar mentalitet fituesi. "Pas barazimit 1:1 në ndeshjen e

parë në Maltë dhe përfundimit të kohës së rregullt në ndeshjen e kthimit me të njëjtin rezultat, kampionët tanë treguan karakter, forcë dhe mentalitet fituesi në vazhdimë. Edhe pse ishte në disavantazh 0:1, Drita reagoi në mënyrën më të mirë, përmbysi rezultatin në 2:1 dhe me plot meritë siguroi kualifikimin në fazën e radhës të kësaj gare. Përgëzime futbollistëve, stafit teknik, drejtuesve të klubit dhe tifozëve 'Intelektualët' për këtë sukses, që nderon jo vetëm klubin, por edhe futbollin e Kosovës. FC Dritës i urojmë shumë suksese në raundin e tretë të UEFA Conference League dhe paraqitje edhe më të mira në vazhdim dhe një përfaqësim sa më dinjitoz të futbollit të Kosovës!", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

PËRPLASJE E RE MES FIFA-s DHE UEFA-s, EVROPIANËT KËRCËNOJNË ME BOJKOT TË KUPËS SË BOTËS

ZURICH, 29 KORRIK - FIFA dhe UEFA janë përfshirë në një tjetër përplasje të fortë, pasi organizata botërore e futbollit ka paraqitur një plan për krijimin e një kompanie të re që do të menaxhojë dhe tregtojë një pjesë të të drejtave komerciale të Kupës së Botës dhe turneve të tjera madhore.

Sipas planit të paraqitur nga presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, do të krijohet kompania FIFA Forward Enterprise (FFE) e cila do të merret me tregtimin e aksioneve dhe të drejtave komerciale të Kupës së Botës për meshkuj, femra si dhe Kupës së Botës për Klube.

FIFA synon ta mbajë kontrollin e shumicës së

aksioneve në kompaninë e re, ndërsa një pjesë e tyre pritet t'u ofrohet investitorëve privatë.

Ky projekt ka hasur në kundërshtim të ashpër nga UEFA, e cila e ka akuzuar FIFA-n se po "shet shpirtin e futbollit". Konfederata evropiane ka paralajmëruar se po shqyrton mundësinë e ndërmarrjes së hapave ligjorë për ta bllokuar këtë iniciativë.

Në kuadër të përshkallëzimit të konfliktit është përmendur edhe mundësia e një bojkoti të Kupës së Botës 2030 nga ekipet evropiane, megjithëse një vendim i tillë nuk është marrë. Në një deklaratë UEFA ka theksuar se qeverisja e futbollit dhe vlerat e këtij



sporti nuk duhet të trajtohen si asete tregtare, duke kërkuar transparencë të plotë lidhur me projektin dhe përfituesit e

mundshëm financiarë.

Sipas medieve britanike, FIFA e ka vlerësuar kompaninë e re në rreth 20 miliardë dollarë,

ndërsa synon të mbledhë rreth 4.2 miliardë dollarë nga shitja e aksioneve të investitorët privatë. FIFA pretendon se të ardhurat shesë do të përdoren për rritjen e fondeve që u shpërndahen federatave anëtare gjatë cikleve të ardhshme të Kupës së Botës. Projekti duhet ende të miratohet nga shumica e 211 federatave anëtare të FIFA-s, ndërsa deri më tani nuk është caktuar një datë për votim. Ndërkohë, tensionet mes FIFA-s dhe UEFA-s vazhdojnë të rriten, duke e kthyer këtë përplasje në një nga konfliktet më serioze vitet e fundit ndërmjet dy institucioneve më të fuqishme të futbollit botëror.

FFK-ja organizon kursin e radhës për trajnerë për Licencën B

PRISHTINË, 29 KORRIK - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) ka njoftuar se do ta organizojë kursin e radhës për trajnerë për përfitimin e UEFA B Licencës. Kursi do të nisë më 24 gusht 2026 dhe do të zhvillohet në disa faza, duke përfshirë ligjëratat teorike, punën praktike, periudhën e praktikës në klub dhe provimet përfundimtare.

Gjatë programit trajnerët do të kenë mundësi t'i avancojnë

njohuritë e tyre në fusha të ndryshme të futbollit, ndërsa temat që do të trajtohen në teori dhe praktikë përfshijnë njohuritë bazë të futbollit, stërvitjen e të rinjve, përgatitjen teknike dhe taktike, përgatitjen fizike si dhe analizën e lojës.

Kursi do të vijojë edhe gjatë muajit shtator dhe tetor, ndërsa pjesëmarrësit do të jenë të obliguar të kryejnë një periudhë praktike në një klub

si dhe ta ndjekin fazën e dytë mësimore. Për t'u pranuar në kurs kandidatët duhet të plotësojnë disa kriterë, përfshirë dorëzimin e vërtetimit nga policia për dosjen penale, certifikatën shëndetësore të lëshuar nga QKMF-ja dhe kopjen e Licencës C.

FFK-ja ka bërë me dije se pjesëmarrja aktive në pjesën teorike dhe praktike është e obligueshme, ndërsa trajnerët

duhet të jenë të përgatitur edhe fizikisht për kërkesat e kursit. Në përfundim të programit kandidatët do t'u nënshtrohen provimeve. Trajnerët që i kalojnë me sukses ato do të pajisen me UEFA B Licencë, e cila shërben edhe si kriter për avancimin drejt licencave të tjera, përfshirë UEFA A Licencën. Pagesa për kursin është 700 euro për person, ndërsa numri i pjesëmarrësve



është i kufizuar në vetëm 24 trajnerë. Trajnerët e interesuar duhet të aplikojnë online përmes uebfaqes së FFK-së, në rubrikën "Aplikimi për trajner", deri më 8 gusht 2026.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Golden Gloves” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811891995 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Golden Gloves” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811891995 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Golden Gloves” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811891995 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “SB-International” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810845026 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “SB-International” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810845026 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “SB-International” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810845026 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun Solar fotovoltaiak “Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60 MW , në Sinajë, Komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.09.2026 në ora 10:00 në objektin në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari” komuna Istog, do të organizohet debat publik nga “Loshi Invest” L.L.C , Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për vlerësimin e ndikimit në mjedis për parkun solar fotovoltaiak “Loshi Energy Farm” me kapacitet 0.60MW" nga kompania “LOSHI INVEST” L.L.C

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

